



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE  
DREJTORIA E MBLEDHJES SË DETYRIMEVE TATIMORE TË PAPAGUARA  
RAJONI QËNDROR

\_\_ Nr. / Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_/\_\_\_\_/ 2020

**Lënda:** Kthim Përgjigje

**Drejtuar :** QËNDRA BIRN ALBANIA

**TIRANË**

Në përgjigje të kërkesës tuaj lënda ‘Kërkesë për informacion dhe vënie në dispozicion të dokumentacionit’ për subjektin EDEN me NIPT K22223004I, ju bëjmë me dije se; Referuar sistemit informatik C@TS tatimpaguesi ka detyrime të papaguara ndaj organit tatimor. Kundrejt këtij detyrimi janë marrë masat shtrënguese në zbatim te legjislacionit në fuqi.

Për sa kërkoni informacion mbi vlerën e detyrimeve tatimore të tatimpaguesit, aksionerët dhe përfaqësuesit ligjor të cilët mbartin këtë detyrim, në zbatim nenit 24 dhe 31 të **Ligjit Nr.9920 Datë 19.05.2008 , Për Proçeduart Tatimore në RSH** , përcaktohet kujt i ofrohet informacion mbi tatimpaguesin dhe ruajtjen e konfidencialitetit të të dhënave të tatimpaguesit.

**Neni 24,** ‘Informacioni tatimor për tatimpaguesin, i administruar nga administrata tatimore, u ofrohet pa pagesë autoriteteve të përcaktuara në këtë nen, pas depozitimit të kërkesës me shkrim dhe kur verifikohen rrethanat e mëposhtme:

a) gjyqtarit, nëse është në gjykim ose në hetim të një çështjeje civile, të lidhur me një tatimpagues, për pjesën që u takon marrëdhënieve të tij me administratën tatimore; b) gjyqtarit apo prokurorit, nëse është në gjykim ose në hetim të një çështjeje penale, të lidhur me një tatimpagues, për pjesën që u takon marrëdhënieve të tij me administratën tatimore; c) Kontrollit të Lartë të Shtetit, vetëm për rastet, kur kërkesa e bërë është në funksion të kontrollit të kryer nga ky institucion ndaj administratës tatimore, në funksion të hartimit të rekomandimeve të veta; ç) autoritetit të ngjashëm të huaj, me të cilin Kuvendi ka ratifikuar marrëveshje ndërkombëtare dhe informacioni kërkohet në kuadër të ekzekutimit të marrëveshjes; d) autoritetit homolog të huaj ose autoriteteve vendase, me të cilat Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi dy ose shumëpalëshe, me objekt shkëmbimin e informacionit; dh) institucioneve të pavarura, të krijuara me ligj; e) çdo autoriteti tjetër, sipas parashikimit të bërë me ligj të vecantë.

**Neni 31**, E drejta për konfidencialitetin e të dhënave të tatimpaguesit; *1. Çdo tatimpagues ka të drejtën e konfidencialitetit për të dhënat e veta tatimore e financiare, të administruara nga administrata tatimore.*

Duke Ju uruar punë të mbarë!